

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar: Anetareve te Bordit te Qendra "Faktoje"

Adresa: Rruga Nasi Pavllo, Pallati Edil Al, kati 3, apartamenti 8, shkalla 1, Tirane

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkangjitur te *Qendra "Faktoje"* te cilat perfshijne pasqyren e pozicionit financiar te dates 31 Dhjetor 2021, pasqyren e aktiviteteve dhe pasqyren e flukseve te parase per vitin qe mbyllet me kete date, si edhe shenimet per keto pasqyra financiare, perfshire nje permbledhje te politikave kontabel me te rendesishme.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare bashkelidhur, paraqesin drejt, ne te gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar te Organizates *Qendra "Faktoje"* me date 31 Dhjetor 2021, si dhe te performances financiare dhe pasqyres se flukseve te parase per ushtrimin e mbyllur ne ate date, ne pajtim me Standardet Kombetare te Kontabilitetit per Organizatat Jo-Fitimpruese te permiresuara (SKK per OJF).

Baza per opinion

Ne e kryem auditimin tone ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit (SNA-te). Pergjegjesite tona sipas ketyre standardeve jane pershkruar ne menyre me te detajuar ne seksionin e raportit ku jepen Pergjegjesite e Audituesit per Pasqyrat Financiare. Ne jemi te pavarur nga Shoqeria ne perputhje me kerkesat etike qe jane te zbatueshme per auditimin e pasqyrave financiare, dhe kemi permbushur pergjegjesite e tjera etike ne perputhje me keto kerkesa. Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene opinionin tone te auditimit.

Çeshjet Kryesore te Auditimit

Çeshjet Kryesore te Auditimit jane ato çeshtje qe, nen gjykimin tone profesional, ishin me te rendesishmet gjate auditimit te pasqyrave financiare te periudhes aktuale. Keto çeshtje jane adresuar ne kontekstin e auditimit te pasqyrave financiare ne teresi, dhe gjate formimit te opinionit tone, per rrjedhoje, dhe ne nuk paraqesim nje opinion te vecante per keto çeshtje.

Pergjegjesite e Drejtimit dhe te Atyre te ngarkuar me Qeverisjen per Pasqyrat Financiare

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit per Organizatat Jo-Fitimpruese te permiresuara (SKK per OJF) dhe per ato kontrole te brendshme qe drejtimi i gjykon te nevojshme per te bere te mundur pergatitjen e pasqyrave financiare qe nuk permbajne anomali materiale qofte per shkak te mashtrimit apo gabimit.

Ne pergatitjen e Pasqyrave Financiare, Drejtimi eshte pergjegjes per matjen e aftesise se vijueshmerise se Kompanise, duke paraqitur nese eshte rasti, çeshtje te lidhura me vijueshmerine dhe te perdore parimin e vijueshmerise vetem ne qoftese ne te kundert, Drejtimi ka per qellim te likuidoje kompanine ose te nderprese veprimtarine, ose nuk ka alternative realiste per te vazhduar.

Te ngarkuarit me Qeverisjen jane pergjegjes per mbikqyrjen e procesit te raportimit financiar te Kompanise.

Pergjegjesia e Audituesit

Objektivat tone jane per te arritur sigurine e arsyeshme per faktin nese pasqyrat financiare jane pa anomali materiale qofte per shkak te mashtrimit apo gabimit, dhe leshimi i raportit te auditimit qe permban opinionin tone. Siguri e arsyeshme eshte nje nivel i larte sigurie, por nuk eshte garanci qe nje auditim i kryer ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit do te zbuloje nje anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalite mund te vijne si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nese, individualisht ose te marra se bashku, pritet qe ne menyre te arsyeshme te influencojne vendimet ekonomike te perdoruesve, te marra bazuar ne keto pasqyra financiare.

Raport per kerkesat e tjera Ligjore dhe Rregullatore

Ne angazhimin tone per auditimin e Pasqyrave Financiare te *Qendra "Faktoje"* nuk ka kerkesa te tjera nga ana e Drejtimit per t'u raportuar nga ne.

Partneret e angazhimit ne auditim qe rezultojne ne kete raport audituesi te pavarur jane:

Audituesi Ligjor / License nr. 260

Erjon Saraçi

E.S. Financial Advisory sh.p.k

Cel: 069 600 22 95

E-mail: erjons@gmail.com

Adresa: Adr: Rruga "Tefta Tashko Koco", Pall nr 132.

Hyrja nr.1 Tirane, Shqiperi

Data 29.04.2022

